

VENDIM

Nr. 371, datë 26.4.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1013, DATË 10.12.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PROVIMEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në titull dhe kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi "Agjencia Kombëtare e Provimeve" zëvendësohet me "Qendra e Shërbimeve Arsimore".

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. QSHA-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit."

c) Pikat 4, 5, 6 dhe 7 shfuqizohen.

ç) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. QSHA-ja kryen këto funksione:

a) Zhvillon provimet kombëtare, kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve dhe administron bazën e të dhënave të këtyre rezultateve.

b) Kryen dhe administron vlerësime të jashtme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe/ose me kampionim për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar.

c) Ofron kontribut në hartimin e politikave arsimore e të strategjive dhe në zbatimin e tyre.

ç) Përpunon dhe analizon rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve, të provimeve të shtetit, sipas standardeve bashkëkohore, dhe raportet vjetore të cilat i publikon.

d) Organizon dhe administron Provimin e Shtetit, që zhvillohet përmes teknologjisë digjitale, duke bashkëpunuar me autoritetet kompetente përkatëse, sipas ligjit për profesionet e rregulluara.

dh) Krijon bazën shtetërore të të dhënave për kandidatët e regjistruar në Provimin e Shtetit.

e) Digjitalizon fondet e pyetjeve të miratuara nga komisionet e Provimit të Shtetit dhe e zhvillon këtë provim, përmes teknologjisë digjitale.

ë) Trajnon periodikisht personelin organizues dhe mbikëqyrës të Provimit të Shtetit dhe të provimeve kombëtare.

f) Publikon *on-line* programin orientues të këtij provimi dhe fondet e pyetjeve për çdo profesion të rregulluar.

g) Administron bazën e të dhënave për arsimin parauniversitar.

gj) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare.

h) Kontribuon në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat janë pjesë e objektit të veprimtarisë së saj."

d) Pikat 9, 10 dhe 11 shfuqizohen.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi